

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 64 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 5 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.1001- 251/1 datë 15.1.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.0201-399/3 datë 26.1.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 4-të mbajtur më 25.1.2024, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrje të masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) METROPOLIS RADIO SHPK Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 64 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), të mënyrës që në shërbimin programor në radio të radiodifuzerit, transmetuar më 9, 10, 11, 12 dhe 13 janar, 2024, në emisionin "Radio aukcija" njoftimet e prezantuesit janë transmetuar fillimisht në gjuhën kroate, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.1001-251/1 datë 15.1.2024 e cila është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojca nr.1.

2. Detyrohet SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup, që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të Shërbimeve Mediatike Audiovizuale sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji në fjalë, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë vërejtje publike në pajtim me këtë ligj, në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 64 paragrafi (1) të LSHMAAV, transmetuesit janë të detyruar që programin ta transmetojnë në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik, dhe në rastet kur programi është i dedikuar për komunitet që nuk është shumicë, në gjuhën dhe shkrimin e atij komuniteti..

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 15 janar 2024, ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore (monitorim), në kuptim **претставка** (UPP 0309/1, datë 12.1.2024) të shërbimit programor në radio të SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup, transmetuar më 9, 10, 11, 12 dhe 13 janar 2024, në nivel shtetëror, nga ku konstatoi shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Përkatësisht, me mbikëqyrjen e jashtëzakonshme u konstatua se më 9, 10, 11, 12 dhe 13 janar 2024, në shërbimin programor në radio të SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup, në emisionin "Radio aukcija", njoftimet e prezantuesit janë transmetuar burimisht në gjuhën kroate, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.1001-251/1 datë 15.1.2024, e cila është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojca nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup, më 17.1.2024, ka dërguar Shkresë me nr.ark.1001-251/2 datë 17.1.2024, me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore me nr.ark.1001-251/1 datë 15.1.2024, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt më 18.1.2024, për të cilën, në afatin e paraparë, SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup ka dorëzuar deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV, nr ynë ark.1001-251/3 datë 18.1.2024. Këshilli i Agjencisë në seancën e 4-të mbajtur më 25 1.2024 ka shqyrtuar lëndën Raport me shkrim dhe deklaratën e dorëzuar me shkrim dhe ka konstatuar që SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup t'i shqiptohet masë - vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 64 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 5 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Teksti i pastruar), Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.1001- 251/1 datë 15.1.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.0201-399/3 datë 26.1.2024, për konstatim të mos respektimit të dispozitave nga LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë së seancën e mbajtur më 25.1.2024, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup dhe urdhëron që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit ta harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryehet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojca (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.1001-251/1 datë 15.1.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.